



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr.17978 Prot.

Lezhë, më 05.12.2023

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
KATEGORIA EKZEKUTIVE**

**Lloji i diplomës “Shkenca Shoqerore/Akademi
Ushtarake/Rendi/Shkenca Juridike/Shkenca Ekonomike/Shkenca të
Natyrës” Nivel minimal i diplomës “Bachelor”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Bashkia Lezhë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil, Udhërit nr.633 datë 30.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2023”, i ndryshuar, Planit të Pranimeve në Shërbimin Civil të vitit 2023, miratuar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.02, datë 06.01.2023, i ndryshuar, Bashkia Lezhë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil, kategoria ekzekutive për pozicionin:

1. Specialist në Drejtorinë e Emergjencave Civile, Bashkia Lezhë, Kategoria IV-a.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil)

aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: Lëvizje paralele	15.12.2023
--	-------------------

Afati për dorëzimin e Dokumenteve: Pranim në shërbimin civil	20.12.2023
---	-------------------

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Harton planin e Emergjencave Civile për bashkinë, duke identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e mundshme që prekin territorin e bashkise dhe e paraqet atë për miratim në Komisionin e Planifikimit dhe Perballimit të Emergjencave Civile të bashkisë (KPPECB).
- Përpunon të gjithë të dhënat për resurset që ka në territorin e bashkise, bazen materiale-teknike nën administrimin shtetëror dhe privat, dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre në situata emergjente.
- Monitoron situatën emergjente në të gjithë bashkinë dhe në vecanti në territoret e Njesive Administrative më të rrezikuara, nëpërmjet marrjes dhe dhënies së informacionit me specialistët e emergjencave civile dhe administratoret e Njesive Administrative të Bashkise.
- Bashkerendon veprimet dhe aktivitetet e strukturave lokale vartese ose jo, në të gjitha etapat e përgatitjes dhe përgjigjes ndaj emergjencës civile, si PMNZSH-ja, dhe të gjitha drejtoritë e ngritura në strukturën e Bashkise, Urgjenca Shëndetsore, Spitalet rajonale/locale, Drejtorinë /Komisariatit e Policisë së Qarkut/Rrethit, degeve të OSSH-se, Degeve të Tatim-Taksave, Degeve të Rrugeve Rurale, Drejtorinë e Ujesjelles Kanalizimeve Sha-ve, Subjekteve kontaktuese private për mirembajtjen e rrugeve, KKSH-se, të vullnetareve dhe të donatoreve të ndryshëm.
- Përcakton vendstrehimet e magazinat e përkohshme dhe pikat e shpërndarjes, dhe nevoja të tjera të mundshme në funksion të mbrojtjes civile.
- Ndjek dhe kërkon nga organet vartese (Njesite Administrative) skemat e njoftim/lajmerimit për komunitetin dhe funksionimit të tyre.

- Parashikon burimet dhe rezervat e nevojshme materiale dhe financiare për sistemimin e popullsisë në raste emergjence nga fatkeqesitë natyrore ose nga fatkeqesitë e tjera.
- Bashkërendon forcat operacionale të ndihmes dhe ato vullnetare, të cilat veprojnë në zonen e prekur nga fatkeqesia me organet e pushtetit vendor.
- I sugjeron Kryetarit të Bashkisë për kerkimin e ndihmes pranë prefektit dhe DPEC, kur situatat e emergjences civile janë përtej mundësive apo kapaciteteve të Bashkisë.
- Zbaton projekte për riaftesim nga emergjencat civile dhe krizat.
- Zbaton detyrat e caktuara nga strukturat e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qendror.
- Merr masa parandaluese dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore dhe harton dokumentacionin përkatës në përputhje me shkresën e Ministrisë së Mbrojtjes nr 8291 prot date 09.11.2015 dhe udhëzimit nr 1185/1 date 18.07.2007 pika 2 b, s, c
- Zbaton detyra të tjera të caktuara nga eprori i tij dhe nga titullari i Bashkisë.
- Është përgjegjës për përgatitjen, përpunimin dhe ndjekjen e informacionit për gjithë veprimtarinë e institucioneve që lidhen me emergjencat civile dhe krizat në nivel vendor e qendror, dhe merr masa për të informuar opinionin publik nëpërmjet mediave elektronike, të shkruara në faqes publike, faqes zyrtare të bashkisë në mënyrë të saktë dhe të shpejtë, si në fazën parapergatitore dhe gjatë dinamikës në situatë të emergjences civile dhe krizash.
- Të përgatisë raporte periodike për KPPECB, KPPECQ dhe DPPEC.
- Të bashkëpunojë me DPEC për vlersëimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesitë natyrore ose fatkeqesi të tjera dhe riaftesimin e tyre në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.
- Të ndjeke dhe të zgjidhe problematiken që lind nga korespondenca nga organet eprore dhe të informoje në cdo rast kur nevojitet ndihma dhe nderhyrja e tyre.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori, (sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar) (niveli i pagës IV-a
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);

- Të kenë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor”, në Shkenca Shoqerore/ Akademi Ushtarake/Shkenca Ekonomike/Shkenca të Natyrës/Shkenca Juridike, (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- c) Të ketë eksperience punë mbi 3 vit pune në administratën shtetërore ose vendore.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Lezhë, dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar
- b- Fotokopje të diplomës
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 15.12.2023.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **19.12.2023**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të bashkisë, listën paraprake të kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.
- e) Njohuritë mbi Ligjin NR.45/2019 “*Për mbrojtjen civile*”.
- f) Njohuritë mbi VKM-në nr.329 “*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*”.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”, të Departamentit të Administratës Publike ëëë.dap.gov.al.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Lezhë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- d) Të jetë shtetas shqiptar;
- e) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- f) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- g) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- h) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- i) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor”, në Shkenca Shoqerore/ Akademi Ushtarake/Rendi/ Shkenca Ekonomike/Shkenca të Natyrës/Shkenca Juridike, (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- c) Të ketë eksperience punë mbi 1 vit pune në administratën shtetërore ose vendore.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 20.12.2023 në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Sherbimeve Mbështetëse, pranë Bashkisë Lezhë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **03.01.2024**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- e) Njohuritë mbi Ligjin NR.45/2019 “Për mbrojtjen civile”.
- f) Njohuritë mbi VKM-në nr.329 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, njohuritë mbi legjislacionin dhe kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Lezhë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e saj zyrtare. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit ne Shërbim Civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Bashkisë Lezhë dhe ne portalin shërbimi kombëtar i punësimit, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **03.01.2024**.

KRYETARI
Pjerin Ndreu